



**Nr i Protokolit 975**

**20.10.2021**

**Rahovec**

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 68 të Ligjit Nr. 06L-114 për Zyrtaret Publik, Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, të datës 29.08.2011, nenit 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it. Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativ për Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

## **Konkurs**

**Për plotësimin e 2 vendeve të lira të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2021/2022:  
Mësimdhënës/e për Lëndën e Fizikës.**

### **Kushtet për konkurim:**

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U.A.05/2021, Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

### **Dokumentet e nevojshme:**

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e certifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime.

### **Mënyra e aplikimit:**

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret /shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>

### **Lista Pritëse:**

Kandidatët të cilët grumbullojnë më shumë se 59 pikë, hynë në Listën pritëse si kandidat fitues, dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë pozitë të lirë-Mësimdhënës/e për Lëndën e Fizikës, kanë të drejtë të punësohen.

### **Themelimi i marrëdhënies së punës:**

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës .

### **Aplikimi në konkurs:**

Afati i aplikimit fillon nga data 22.11.2021 dhe zgjat 15 ditë kalendarike dhe atë deri me datë 06.12.2021, deri në ora 16<sup>00</sup>.

**Rahovec,  
20.10.2021**



**Avni Morina, Drejtor**